



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-14-5000

Ankuesi

H B Gj.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 25 janar 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI085-1693, i datës 28 maj 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore për parashtruesin e kërkesës.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 30 qershor 2014, ankuesi parashtroj ankesë/këkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI085-1693 të datës 28 maj 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për pagat e papaguara në shumë prej 6,300.00 €, për periudhën gusht 2001 – maj 2005 nga NSH “I” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ka qenë i punësuar në “I” nga viti 1980 deri në vitin 1990 si dhe prej datës 1999 deri në vitin 2006 kur kjo ndërmarrje është privatizuar. Sipas ankuesit ai ka paraqitur kërkesë në AKP dhe ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 6,300.00 euro për periudhën gusht 2001 – maj 2005 nga NSH “I” dhe e njëjta është refuzuar si e pa vlefshme.

Ankuesi në vazhdim e kundërshton në tërësi dhe konsideron se janë bërë shkelje në nxjerrjen e tij ngase nuk janë vërtetuar provat e paraqitura në kërkesë, në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se nuk është gjetur se ka ndonjë detyrim ndërmarrja ndaj palës. Në fund ankuesi

propozon gjykatës që të anulohet vendimi i lartëcekur si i pa vlefshëm dhe propozon që të mirret vendim i ri ku do të aprovohet kërkesa e tij lidhur me kopsensimin e pagave në shumë prej 6.300.00 euro për periudhën 2001-2005.

Së bashku me ankesë ai ka bashkëngjitur kopjen e vendimit GJI085-1693 I datës 28.05.2014, Vërtetimin mbi përvojën e punës e lëshuar nga AKP e datës 26 qershor 2014, kopjen e Librezës së punës me nr. 53748, kopjen e vendimit nr.1241/205 I datës 27.06.1980, kopjen e letërnjoftimit.

Me datën 05.11.2014, gjykata lëshon urdhër për pagesën e taksës gjyqësore, me datën 18.11.2014 ankuesi ka bërë pagesën e saj.

Me datën 16 nëntor 2022, gjykata lëshon urdhër me të cilin kërkon nga ankuesi prova shtesë në mbështetje të ankësës së tij.

Me 25 nëntor 2022, ankuesi përgjigjet në urdhërin e gjykatës dhe i bashkëngjet

- Kopjen e njoftimit për ndërpreje të marrëdhënies së punës e datës 01 dhjetor 2006,
- Kopjen e regjistrave të punëtorëve.

Me datën 21 dhjetor 2022, gjykata lëshon urdhër për Agjencionin Kosovar të Privatizimit me anë të cilit kërkon parashtrimin e përgjigjes.

Me 10 janar 2023, AKP parashtron mbrojtjen e saj me të cilën thekson se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme në pajtim me qëndrimin e vetë parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar Vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 Ankesa në fjalë është e pa bazuar.

Pala kundërshtarë thekson se pretendimet e parashtruesit janë të parashkruara pasi që nuk ka asnjë provë përpara AL-së që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent gjatë periudhës tre vite nga viti 1999.

Pra Kërkesa e parashtruesit është e parashkruar në pajtim me Nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 dhe neni 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Në fund mbrojtja e AKP-së thekson se në bazë të dispozitave të lartëcekura kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve, nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos i ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Pra, tri vite nga koha kur parashtruesi nuk ka përfituar nga ndërrmarja të ardhurat personale të pretenduara, nga gusht 2001. Në fund fare AKP i propozon gjykatës që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pa pranueshme dhe e pa bazuar dhe këkon që të vërtetohet vendimi i AL-se në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit 06/L-086.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtorë e NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh ndonjë pagë, gjatë periudhës së kërkuar. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij.

Ankuesi nuk ka sjell prova shtesë të mjaftueshme të kërkuara nga gjykata, për të vërtetuar lartësin dhe periudhën e pagave të mbetura borxh, andaj në mungesë të dëshmimeve, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Sa i përket parashkrimit të kërkesës të cilën ankuesi e ka arsyetuar, gjykata e vlerësoi pa e marr si pretendim kryesor, për faktin se çështja e parashkrimit është institut i veçant me afate të përcaktuara me ligj e të cilat nuk do të ishte fare e vështirë të përcaktohet pasi që njoftimi mbi ndërprerje të mardhënjes së punës veq e kishte ndërprerë parashkrimin. Por, në këtë rast gjykata u mbështet në provat e prezentuara nga ankuesi, të cilat nuk ishin të mjaftueshme për t'ia aprovuar kërkesën për pagat e papaguara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i mbulojë shpenzimet e veta.

Parashtruesi i kërkesës ka paguar taksën gjyqësore.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e

Hajrie Shala